

## 1 VIZITA GJATË VALLËZIMIT

- 1.1 Grupi i valltarëve stërvitet / ushtron çdo të premte në këtë orar:
- 1.2 Grupi i fëmijëve 18.00 – 19.45 (15min pauzë në këtë orar)
- 1.3 Grupi i të rriturve 20.00 – 22.00 (15min pauzë në këtë orar)
- 1.4 Çdo grup përmban dy leksione nga 45 minuta.
- 1.5 Vizitat gjatë vallëzimit janë zakonisht çdo të Premte të mundshme në paraqitje të një kërkesë disa ditë përpara.
- 1.6 Çdo të premte të fund muajit lejohet pa paraqitje të kërkesës të vizitohen fëmijët gjatë vallëzimit.
- 1.7 Çdo pengesë brenda kohës kur vallëzohet është e ndaluar.
- 1.8 Biseda të shkurta apo pyetje mësueses mund ti shtroni në pauzë ose mbas mbarimit të mësimit.

## 2 PROVAT PARA REGJISTRIMIT

- 2.1 Çdo i interesuar ka mundësi pasi të mbush formularin, të vijë 4 Javë (1 Muaj) si provë pa pagesë që të ketë mundësi ta njoftojë grupin.
- 2.2 Në raste që i interesuari shpreh dëshirën të regjistrohet pa prova, bëhet regjistrimi me një procedurë të shpejtë, ku i konfirmohet regjistrimi dhe i dorëzohen veshjet e valltarëve.
- 2.3 Në Rastin 2.2 regjistrohet automatikisht në “Chatin” e grupit të përcaktuar.

## 3 REGJISTRIMI

- 3.1 Regjistrimi bëhet me shkrim apo online në formularin e faqes të Shoqatës.
- 3.2 Të interesuarit mbi moshën 18 vjet mund ta mbushin formularin e përmendur personalisht dhe të nënshkruhen për përgjegjësit e tyre.
- 3.3 Të interesuarit prej moshës 5 deri në moshën e përfunduar prej 17 Vjeq duhet të marrin nënshkrimin nga Prindërit e tyre.
- 3.4 Pasi të dorëzohet formulari i nënshkruar, bëhet regjistrimi në sistem nga përgjegjësit e Shoqatës ku dhe do të shtypet Fatura gjysmë vjetore.

## 4 PËRJASHTIMI

- 4.1 Përgjashtimi nga grupi i valltarëve mund të vendoset për arsye të shumta:
- 4.2 Nëse personi pengon dhe nuk respekton mbarëvajtjen e ushtrimeve.
- 4.3 Personat që nuk respektojnë rregulloren, do të marrin vërejtje me shkrim.
- 4.4 Mbas 3 vërejtjeve brenda Vitit, mund të vjen deri te përgjashtimi nga Grupi i valltarëve.
- 4.5 Nëse nuk paguhet Fatura mbasi është informuar (Rikujtim për Pagesë) dy herë nga përgjegjësit e financave të kryesisë së Shoqatës Bashkimi.
- 4.6 Përgjashtimi mund të ankohet me shkrim në adresën e Shoqatës Bashkimi në Uster.
- 4.7 Kryesia e Shoqatës e shqyrton ankesën e prindit apo të valltarëve dhe jep brenda një kohe prej maksimal 14 dite një përgjigje po ashtu me shkrim për vendimin e marrë.
- 4.8 Ankesë në një shkallë më të lartë se kjo e kryesisë nuk ka sepse Kryesia e Shoqatës është organi më i lartë i Shoqatës Bashkimi dhe çdo ankesë tjetër refuzohet.

## 5 PAGESAT

- 5.1 Pagesat për vallëzim bëhet në dy faza
- 5.2 Fatura 1: **Janar – Qershor** që duhet të paguhet deri në **fund të muajit Janar**
- 5.3 Fatura 2: **Korrik - Dhjetor** që duhet të paguhet deri në **fund të muajit Gusht**
- 5.4 Pagesat kontrollohen në mënyrë automatike nga sistemi ku dhe informohet stafi për mos pagesën e faturës në kohën e duhur.
- 5.5 Personat që fillojnë vallëzimin në mes të sezonit duhet ta bëjnë pagesën në bazë të muajve që vallëzojnë deri në fund të sezonit.
- 5.6 Personat që dalin nga vallëzimi pa ndonjë arsye nuk u kthehet pagesa e bërë.

## 6 VESHJET KOMBËTARE

- 6.1 Çdo valltar pasi të regjistrohet përfundimisht në grupin e valltarëve do të merr veshjet kombëtare nga Shoqata Bashkimi.
- 6.2 Kompletin e veshjeve kombëtare duhet regjistruhet dhe të merret në shtëpi.
- 6.3 Personi që i merr veshjet kombëtare është përgjegjës për to deri në dalje nga grupi.
- 6.4 Për raste keqpërdorimi apo humbje të kompletit të veshjeve, detyrohet Valltari apo prindi i tij të bëjë pagesën e plotë deri **300 SFR**.
- 6.5 Nëse dëmtohet ose humbet një pjesë e kompletit, pagesa duhet të bëhet një shumë prej **50 SFR**.
- 6.6 Çdo valltarë merr nga një Bluzë (T-Shirt) nga Shoqata ku mund ta përdor për Orët e Vallëzimit.
- 6.7 Çdo valltarë është i obliguar gjatë ushtrimeve të jetë i veshur si më poshtë:
  - 1. T-Shirt me Logo të Bashkimit
  - 2. Veshje sportive (Trenerka, Atlete-Patika, "Turntäppeli")
  - 3. Flokët e gjata duhet të jenë të lidhura.
- 6.8 Në rast kur valltarëve i mungojnë bluza, duhet ti lajmërojnë sa më shpejt përgjegjësit e vallëzimit.

## 7 PËRGATITJET PËR MANIFESTIME

- 7.1 Plan programi për manifestime apo festa tjera koordinohen nga përgjegjësit e grupit të emëruar nga Kryesia e Shoqatës Bashkimi.
- 7.2 Përgatitjet fillojnë disa javë përpara dhe përcaktohen grupet.
- 7.3 Valltarët kanë të drejtë ta arsyetojnë mospjesëmarrjen në manifestime.
- 7.4 Mospjesëmarrja duhet të deklarohet në atë ditë kur startohet planifikimi i Manifestimit.
- 7.5 Nëse dy herë (ushtrime) para manifestimit konstatohet mungesa e valltares ose valltarit, nuk mund të planifikohet pjesëmarrja në shfaqje.
- 7.6 Çdo ndryshim apo dëshirë mund të ndryshohet në pajtim me përgjegjësit e Vallëzimit.
- 7.7 Përgjegjësit e vallëzimit kanë të drejtë ta refuzojnë pjesëmarrjen në manifestim nëse deklarohet mos përgatitja nga ana e valltarëve.
- 7.8 Në kohën kur bëhet plan programi valltarët duhet të kujdesen që ushtrimet të mbahen sa të jetë e nevojshme.
- 7.9 Çdo valltar duhet ti kontrollojë vetë kompletin e veshjeve për manifestim.
- 7.10 Nëse mungon diçka, është i detyruar sa më herët të informoj përgjegjësit e vallëzimit.

## 8 MANIFESTIMET

- 8.1 Në manifestime duhet që valltarët ti përmbahen rregullores së kryesisë së Shoqatës dhe të vendit se ku ndodhen.
- 8.2 Pjesëmarrja në manifestime koordinohet me plan programin dhe përgjegjësit e vallëzimit.
- 8.3 Shoqata Bashkimi garanton në çdo manifestim që valltarët të kenë ushqim, pije dhe transport në raste udhëtimi të largët.

## 9 SUGJERIMET / PYETJET

- 9.1 Në raste mosmarrëveshje apo pyetje çdo Prind apo përgjegjës i fëmijëve ka të drejtë të kërkojë bisedë me mësimdhënësen / in.
- 9.2 Nëse biseda apo marrëveshja nuk do të ketë sukses, i lejohet prindit të kërkojë bisedë me përgjegjësitet nga Kryesia e Shoqatës. Kjo bisedë duhet të realizohet në mes të prindit, mësimdhënësit, valltarit apo valltares dhe përgjegjësitet nga kryesia.
- 9.3 Nëse këto dy shkallë të bisedimeve nuk vijnë deri te një përfundim të kënaqur nga të dy palët, atëherë mund të kërkolet që Kryesia e gjerë ta shqyrtoj problemin.
- 9.4 Të gjitha këto kërkesa duhet të raportohen me shkrim dhe të arkivohen në Shoqatë.

## 10 GRUPET

- 10.1 Në bazë të numrit të valltarëve, Shoqata Bashkimi është e detyruar të formoj grupet në bazë të arritjes së suksesit të vallëzimit.
- 10.2 Suksesin e vallëzimit e verifikojnë përgjegjësitet e grupit ku edhe përpunojnë ndarjen e grupeve.
- 10.3 Grupet janë në këtë mënyre të ndara:
- 10.4 Grupi i fëmijëve - **(Fluturat)** Lokacioni: Freizeit- und Jugendzentrum Frjz
- 10.5 Grupi i fëmijëve - **(Harabelat)** Lokacioni: Primalschule Oberuster
- 10.6 Grupi i fëmijëve - **(Dallëndyshet)** Lokacioni: Mehrzwecksaal Kreuz
- 10.7 Grupi i fëmijëve - **(Pulëbardhat)** Lokacioni: Lokali i Shoqatës Bashkimi
- 10.7 Grupi i të rriturve **(Shqiponjat)** Lokacioni: Mehrzwecksaal Kreuz
- 10.8 Grupi fillestar i të rriturve duhet të shqyrtohet me përgjegjësitet e Grupit.
- 10.9 Transferimi nga grupi në grup tjetër mund të ndodhe çdo herë kur tregohet sukcesi.
- 10.10 Suksesin e transferimit e vendos përgjegjësi i grupit në bashkëbisedim me Stafin.
- 10.11 Edhe transferimi nga grupi i përparuar në grupin fillestar lejohet nëse nuk tregohet interesi i nxënësve.
- 10.12 Qëllimi i ndarjes ka vetëm arsye të suksesit e jo personal, moshe apo gjinie.
- 10.13 Përgatitjet e grupeve për Manifestime bëhen të përbashkëta në bazë të plan programit.
- 10.14 Grupet mbikëqyren nga minimum dy persona të autorizuar nga Shoqata Bashkimi.
- 10.15 Për shkaqe logjistike nuk mund të mbahen në të njëjtin vend.
- 10.16 Prindërit informohen disa ditë përpara se në cilin lokacion mbahen ushtrimet.

## 11 PËRGJITHSHËM

- 11.1 Për Grupin e fëmijëve, janë prindërit përgjegjës për sjelljen dhe marrjen nga Ushtrimet.
- 11.2 Çdo vonesë mbas orarit të caktuar e arsyeshme duhet sa më parë të informohen përgjegjësitet e grupit dhe të konfirmohet informacioni.

Kjo Rregullore është miratuar më datën 01. Janar. 2022 e aprovuar nga Kryesia e Shoqatës Bashkimi dhe hyn në fuqi me datën **15. Janar 2022**. Kjo Rregullore e zëvendëson Rregulloren e Datës 17. Nëntor. 2019 në të gjitha pikat.

**Uster, 15. Janar. 2022**  
**Kryesia e Shoqatës Bashkimi**

Keni lëxuar me vëmendje Rregulloren e Vallëzimit dhe pajtoheni me të gjitha pikat e vijara: Po  Jo

Emri i Prindërit: \_\_\_\_\_

Emri i Valltares/it: \_\_\_\_\_

Data: \_\_\_\_\_

Vendi: \_\_\_\_\_

*Ju lutemi ta nënshkruani Rregulloren dhe të na ktheni në formë Fotografie (WhatsApp, SMS, Mail, Viber) apo t'ja dorëzoni Stafit të vallëzimit*

Nënshkrimi: \_\_\_\_\_